



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 060/01-8615/19  
Kaçanik, 29.03. 2019

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e III ( Tretë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 29 Mars 2019. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarë - të gjithë.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, të gjithë drejtoret e drejtive komunale 7 (shtatë), ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin : Bejtulla Dalloshi, Fatlume Guri-Selimi dhe Arbnora Kuka.

Nga OSBE, mbledhja u monitorua nga, Faruk Dërmaku.

Për t'i përcjellë punimet e kësaj mbledhje, pati të interesuar edhe nga radhët e qytetarëve të komunës.

Mbledhja u monitorua përmes Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli,** Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, e konstatoj kuorumin duke i thirrur emër për emër. Pjesëmarrës në mbledhje janë 27 anëtarë-të gjithë anëtarët e KK, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi Mbledhjen e III të Rregullt të Kuvendit të Komunës, përvitin 2019, data 29 Mars, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Prosesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Plani Komunal i Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE) për 2019-2021;
3. Propozim Vendimi për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës, parcelat kadastrale; 00174-0 dhe 00175-0, Zona Kadastrale Doganaj, për ndërtimin e shkollës së Re "Ali Asllani" në f. Doganaj;
4. Propozim Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të parcelave kadastrale Nr. 00229-2 dhe 00229-4, ZK Doganaj, në pronësi të Naser Guri;
5. Propozim Vendimi për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut;

6. Raporti i Punës i Komitetit për Komunitete, për vitin 2018;
7. Raporti i Punës së Komitetit për Shërbime Publike, për vitin 2018; dhe
8. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e Vendimit të KK 01 Nr. 05-400/01-4632/19 të datës 27.02.2019- Për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti fiskal 2018, në buxhetin e komunës të vitit 2019.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit sqaroj së: Pika e fundit ka hyrë në rend pune në bazë të Rekomandimeve të nivelit qendror, pasi vendimi është gabuar për, 3, 29 € ( tre euro e njëzetënëntë cent). Edhe pse ne e kemi përmirësuar vendimin, ata kanë kërkuar me u bërë ndryshimet me Vendim të Kuvendit të Komunës. Lidhur me rendin e propozuar të punës, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë, Rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

#### **APROVOJ**

**Rendin e Punës në përbërje prej 8 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

Procesverbal i mbledhjes së II-të (Dytë) të Rregullt i Kuvendit të Komunës u aprovua njëzëri pa ndonjë vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

#### **APROVOJ**

**Procesverbalin nga mbledhja e II-të (Dytë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2019 të datës 27 Shkurt 2019. / Lënda: 01Nr. 060/01-4976 /19.**

**Kryesuesi i Kuvendit**, Para se me kaluar në pikën e dytë, kalojmë në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave;

#### **Pyetje dhe Kërkesa**

**znj. Lirije Luta**, Paraqiti një vërejtje, drejtuar drejtoreshës së DSHMS, Diana Reka, për injorimet për shkak të veshjes në organizimet përkujtimore të mbajtura me 24 Mars 2019, në f. Kotlinë, datë kjo, ku bëmë marsh nga vendi ku kishte rënë heroikisht dëshmori i f. Ivajë, Neshat Rexha, deri në f. Kotlinë, ku në këtë marsh, sipas vendimit të Këshillit të fshatit Ivajë mund të merrnin pjesë çdokush sipas dëshirës. Data 24 Mars, kur filluan bombardimet e NATO-s, shënuan fillimin e fundit të një epoke të rëndë për popullin shqiptar në Kosovës, Bombardimet 78 ditësh të NATO-së, i paraprinë përpjekjet e shumta të UÇK, sakrificat e panumërtë të popullit shqiptar, që ia hapën rrugët çlirimt dhe lirisë së Kosovës. Andaj, në shenjë të solidarizimit dhe respektit për këtë datë historike, në nderim të lartë të sakrificës sublime të UÇK, të dëshmorëve tanë që ranë, që ne dhe brezat e ardhshëm të jetojnë të lirë, unë mora pjesë në atë organizim me një veshje më ndryshe dhe kapelë me Emblemë të UÇK-së, ku në saje të veshjes sime, u injorova nga drejtoresha, ndërkaq kërkoi nga drejtoresha të ketë kujdes për hera tjera nga injorime të tillë !

#### **z. Hajredin Luta:**

1. Pyetja e parë është për DAK; Në shkollën filllore "Dituria" në f. Ivajë, nxënësit e klasës së dytë, ka një muaj ditë që janë pa arsimtar. Lidhur me këtë çështje është njoftuar edhe më

herët drejtori i DAK. Pyetja është në emër të prindërve dhe të nxënësve; Përse nuk është bërë ende zëvendësimi i arsimtarit i cili ka punuar me klasën e dytë?

2. Pyetja e dytë është për DSHPE; E di së është bërë një Marrëveshje për rehabilitimin e të gjitha rrugëve lokale që janë dëmtuar. Me intereson të di për trasenë e rrugës së f. Gajre, a është e mundur të bëhet kjo trase, kur ka me u rregulluar kjo, sa është gjerësia e rrugës dhe kush ka me realizuar atë projekt ?

#### **Afërdita Horuni;**

1. Pyetje e parë është për Drejtorin e Shërbimeve Publike; Kur do te merrni me riparimin e gropave ne qytet, pasi që dy aksidente ndodhen brenda një kohe të shkurtër: njëra ne bulevard dhe tjetra afër, Bubearit edhe pse kjo e fundit mund të thuash se nuk është kompetencë e komunës, mirëpo ju duhet të paraqitni ankesat në ministri apo ndoshta po pritni qe qytetarët t'i dërgojnë ankesat ?

2. Pyetje e dytë është për Drejtorin e Arsimit; Nga përgjigjeje e dhënë znj. Kaltrina Tafili, për nxënësit te cilët mbajnë kujdestari në shkollën fillore "Emin Duraku" mendoj qe është mjaftë shqetësuese edhe nga ana e prindërve, pasi që dihet që ata mjaftë mësim kanë humbur gjatë grevës dhe kjo i bien që përsëri të humbasin mësim.

3. Pyetje e tretë është për Drejtorin e Bujqësisë; Me intereson të di, çfarë masa keni marrë për parandalimin e shkatërrimit të pyjeve të komunës së Kaçanikut ? Nëse veç i keni marrë masat, dëshirojmë të njoftohemi, e në qoftë së ende nuk keni marrë veprime për ndaljen e këtyre këto dukurive, atëherë kur do t'i merrni parasysh këtë çështje?

**znj. Arlinda Rakoci-Raka;** Kam një Kërkesë drejtuar Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës; Duke parë shumë parregullsi në institucionin parashkollar QEAP "AGIMI", ju drejtohem që t'i ndërmerrni masat e nevojshme. Në këtë institucion, nëse një fëmijë ka ngecje në të folur, mos socializmi ose ndonjë nevojë tjetër të veçantë, aty ndihet diskriminohet, ndihet inferior dhe i pabarabartë me të tjerët, ku ne këtë mënyrë bëhet shkelje esenciale e Ligjit mbi edukimin parashkollar përkatesisht e Nenit 4 ku ky nen bazohet ne këto parime: barazi, gjithë përfshirje, mundësitet e barabarta për fëmijët dhe prindërit, duke marre parasysh ndryshimet ne mes te fëmijëve, dhe Nenit 6 pika 6.1. Të po këtij ligji dhe po ashtu bëhet shkelje e Udhëzimit Administrativ Nr. 19/2016 për përfshirjen e fëmijëve ne institucionet parashkollore dhe atë shkelje te dispozitave te nenit 4 pika 6. E nëse një ankesa e tille behet tek drejtoresha e këtij institucioni asnjëherë nuk gjen mbështetje dhe mirëkuptim, andaj ju drejtohem Juve si drejtor i arsimit. Edhe një gjë dua ta ceki, pasi kam qenë në këshillin drejtues të këtij institucioni kam dhënë dorëheqje pas incizimeve telefonike. Besoj së këto çështje do t'i merrni parasysh, sepse ka pasur edhe ankesa të tjera nga prindërit e fëmijëve të çerdhes.

**z. Shpend Krusha,** Kam një Kërkesë për DSHPE në emër të lagjes, Tifek, ashtu që rruga ku kyçesh në magjistrale, të pjesa e rrugës për Sllatinë, të vendoset një Pasqyrë, sikurse është vendosur në rrugën; Gajre- Ivajë, sepse ka probleme në atë pjesë.

#### **z. Ekrem Kyçyku,**

1. A jeni në dijeni së në SHMP, "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka", një arsimtar i ofron cigare nxënësit të vet ? A është marrë ndonjë veprim konkret nga organet përkatëse ndaj arsimtarit në fjalë ?

**2.** Çështja e degradimit të natyrës për gjatë lumit Lepenc që po bëhet, në veçanti për gjatë rrugës së vjetër në relacionin për Shkup, unë i kam bërë disa foto për degradimet në fjalë, ndërkaq kërkoj të di; Kur do të merren veprime të nevojshme nga organi përkatës, për ndaljen e degradimit në fjalë dhe kur do të shqiptohen gjobat e para për ndotjen e ambientit?

**znj. Kaltrina Tafili,** Kam një Ankesë nga qytetarët e Lagjes “Raif Krivenjeva” për çështjen e mungesës së ndriçimit publik në atë rrugë, sepse qytetarët e komunës në atë pjesë, janë të rrezikuar në orët e natës, për shkak të mungesës së ndriçimit publik. Sa i përket ndriçimit publik, jo vetëm kjo rrugë, por edhe gjitha rrugët tjera të Kaçanikut, kanë nevojë për ndriçim publik.

**z. Bekim Koxha,** Ku qëndron arsyaja që vetëm 8 nxënës të shkollës fillore në f. Koxhaj barten për në shkollë, ndërkaq nxënësit tjerë nuk bartën për në shkollë?

**z. Zahir Doda- drejtor i DAK,** Të çështja e kujdestarisë së nxënësve në shkolla, unë kam dhënë përgjigje profesionale në këtë pyetje. Kjo është çështje e brendshme e shkollës.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Meqë nuk ka kërkesa të tjera, përgjigjet do t'i merrni nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhjen vijuese të KK, ndërkaq potencoja vërejtje për mënyrën e ngritjes së kërkesave apo pyetjeve, ashtu që, Pyetjet apo Kërkesat të cilat ngritën, duhet të janë të shkurtër dhe koncize, të dihet qëllimi i tyre që janë për ekzekutivin e komunës për përgjigje, ndërkaq çështjet personale, duhet të zgjidhen në ndonjë formë tjetër.

**2. Plani Komunal i Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE) për 2019-2021;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Për sqarime të nevojshme fjalën e ka drejtorit të DSHPE, Ramadush Osmani.

**z. Ramadush Osmani – drejtor i DSHPE,** Ky Plan është derivat i Planit Komunal për Eficientë 5 vjeçar (2016-2021), ndërkaq përmes tij Plani, janë paraparë hapat që do të merren për eficientë të energjisë elektrike. Plani është hartuar nga kompania në bashkëpunim grupin punues nga DSHPE, i cili i ka ofruar të dhënat e nevojshme kompanisë për hartimi e tij, ku pjesë e këtij grapi punues edhe unë. Plani është mbështetur nga Zyra e Bashkësisë Evropiane, ndërkaq do të zbatohet nga kompania kontraktuese. Qëllimi i këtij plani, është evidentimi i konsumimit të energjisë elektrike në objektet publike dhe mënyra e kursimit të saj në ato objekte, ku parashihet një kuotë e kursimit të energjisë elektrike dhe sasia e energjisë ngrohëse minimumi, 9% në bazë të planit nacional. Në këtë plan janë shënuar objektet ku do të bëhen analiza për çështjen e konsumimit të energjisë. Në vazhdim drejtori potencoja me shifra numrin e objekteve, ku do të merren veprime të nevojshme për izolimin e tyre, me qëllim të kursimit të energjisë elektrike, si ato: (arsimore, shëndetësore dhe administrative), ndërkaq shtoj së, fillimi i testimi do t'i bëhet 3 shkollave të komunës (Dubravës, Bobit dhe SHF “Emin Duraku” në Kaçanik), për të cilat mendojmë se do të térheqim edhe investime me marrjen e masave eficientë. Prioritet ka qenë edhe ndriçimi publik për me hyrë në këtë plan veprimi, por është hequr, sepse nuk është treguar i suksesshëm në komunat tjera ku e kanë aplikuar, si; Ferizaj etj. Pritjet janë që, nëse bëhet izolimi i tyre, kursimet e energjisë elektrike do të janë, 50% e tyre. Në analiza është marrë për bazë shpenzimi i rrymës, lloji i lendes djegës që përdoret dhe në kalkulum është vërtetuar se këta objekte shpenzojnë më tepër energji elektrike, sesa kërkohet me norma standarde. Drejtori në vazhdim dha edhe sqarime të tjera të nevojshme rreth këtij plani veprimi.

**Kryesuesi i Kuvendit**, I dëgjuat sqarimet e drejtorit, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Selim Reka**, Ky Plan i efecientë, është debatuar edhe në mbledhjen e KPF. Me këtë plan, dihet se do të bëhet izolimi i disa objekteve; administrative, shkollore dhe shëndetësore, me qëllim të kursimit të energjisë elektrike. Është e mirë që po bëhet këto izolime të objekteve, ndërkaq vërejtjet janë se, nuk janë paraparë në këtë plan, panele solare që prodhojnë energji elektrike, kur dihet se lënda djegëse-dru, dita ditës veç është duke u shkatërruar. Kështu që është mirë dhe e nevojshme të fillohet me prodhimin e energjisë, me panele solare,

**z. Ekrem Kyçyku**, Ky plan është voluminoz, janë paraqitur objektivat dhe përfitimet nga realizimi i këtij plani, mirëpo shqetësuese është lënda djegëse-dru, e cila është kryesore për nxehje në objekte publike, ndërkaq ne e dimë së pyjet e komunës tonë, dita ditës veç po shkatërrohen. Në këtë Plan veprimi, shihet se janë paraparë tri shkolla për testim me iu bërë izolimi, ndërkaq është mirë të shtohet numri edhe i objekteve të tjera, sepse është nevojë e kohës kursimi i mjeteve buxhetore të komunës dhe shtimi i energjisë elektrike përmes paneleve solare.

**z. Besim Vishi**, Është mirë që janë selektuar tri objekte shkollore, për analiza të kursimit të energjisë elektrike, megjithëse unë kam pritur të ketë me tepër objekte për analiza. Projekt të efecientësh ka pasur edhe më herët, mirëpo ne nuk kemi të dhëna se sa është kursyer energjia elektrike në objektet të cilat janë marrë veprime për izolimin e tyre. Plani është i përgjithshëm e jo i konkretizuar, ndërkaq edhe auditivet është mirë me qenë më në detaje. Të shkolla fillore “ Kadri Zeka” në Dubravë, më intereson të di, ato mjete buxhetore a janë nga fondi për efecientë apo nga fondi i mjeteve buxhetore të DAK. Në përgjithësi është mirë që është bërë ky Plan i veprimit për kursimin e energjisë elektrike.

**znj. Nazife Krasniqi**, Është një punë e mirë që është bërë ky Plan veprimit për efecientë, ku janë paraqitur objektivat, janë kategorizuar objektet të cilat do të izolohen, ndërkaq të pozicioni ku thuhet, komuna nuk ka menaxher për efecientë, me intereson arsyja pse nuk ka zyrtar të tillë, a nuk ka person adekuat, nuk ka mjete buxhetore apo është kjo njëjtë për gjithë komunat tjera të Kosovës. Në një konferencë e cila është mbajtur me 21 Dhjetor 2018, ndërkaq ka edhe Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, në atë konferencë është bërë Inaugurimi i projektit efecientë, janë ndarë edhe mjete në shumë 80.000€. Me intereson të di qysh kanë me u shpërndarë ato mjete për komuna.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Ky Plan pune është 2 vjeçar, kështu që të orientohemi në këtë plan veprimi, e jo çka mund të bëjmë ne për 10 vjet për çështjen e energjisë efecientë.

**z. Ramadush Osmani**, Arsyja pse janë caktuar tre objekte për testim, do të bëhen analiza konkrete për secilën nga to, në formë të detajuar, ku në mesin e tyre mund të hynë edhe masat efecientë që duhet marrë. Është caktuar një shumë e caktuar e mjeteve, ku në mesin e tyre mund të kalkulohen veprimet që duhet marrë, përfshirë edhe panelet solare, ndërkaq mund të shtohen objektet për testim nga tri sa janë paraparë, në 4 apo më tepër. Të çështja e energjisë, ngrohjes me dru, në raport me komuna tjera, ne jemi një hap përpëra, sepse ato ende nuk e kanë Planin 5 vjeçar efecientë, ndërkaq ne kemi hartuar Planin e veprimit për hapat të cilët duhet t'i marrim. Lënda djegëse dru- dominon me 75%, do të analizohet edhe ky auditiv dhe mundësia e materialit tjetër për ngrohje, si përmes paneleve diellore përmes ndërrimit të kaldajave - për përdorimin e një alternative tjetër për ngrohje. Enamosok është Programi i instaluar në SHMP nga GIZ-i gjerman, në të cilin program futën të dhënat dhe i raportohet GIZ-it dhe Ministrisë përkatëse mbi gjendjen e objektit para dhe pas marrjes se

veprimeve për efecientë. Menaxher për efecientë nuk kemi, sepse nuk ka mjete buxhetore, por kemi zyrtar me punë shtesë i cili raporton për këtë çështje, ndërkaq kërkohet me pasur sektor të veçantë për efecientë, me 2 punëtor, por shpresojmë kjo të bëhet me një organogram të ri të komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë Plan veprimi e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Aprovimin e Planit Komunal të Veprimit për Efiçencën e Energjisë (PKVEE) për 2019-2021.**

**3.** Propozim Vendimi për bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës, parcelat kadastrale; 00174-0 dhe 00175-0, Zona Kadastrale Doganaj, për ndërtimin e shkollës së Re “Ali Asllani” në f. Doganaj;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Besoj se e dini së në vitin 2019, nga MASHT e ka në projekt; Ndërtimin e shkollës së re në f. Doganaj, ndërkaq është ndarë edhe buxheti për këtë projekt. Neve si komunë na mbetet për obligim, Caktimi i lokacionit për ndërtimin e kësaj shkolle. Propozim Vendimit iu ka bashkangjitur një Marrëveshje e lidhur në mes të dy drejtoreve, DAK dhe DSHMS për bartjen e drejtës së shfrytëzimit, mirëpo kjo marrëveshja bien nga fuqia, sepse MAPL na ka sugjeruar që Marrëveshje mund të lidhë vetëm Kryetari i Komunës. Gjithashtu MAPL na ka sugjeruar që emërtimi i kësaj lënde të jetë: **Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e shkollës “Ali Asllani” në f. Doganaj.** Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

**z. Bekim Koxha,** Parashtroj pyetje, a është e mjaftueshme hapësira e propozuar për ndërtimin e shkollës dhe a i plotëson kushtet ai lokacion me u ndërtua shkolla aty.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Sqaroj për sipërfaqen e lokacionit për shkollë, ndërkaq shtoj së prona është komunale. Në atë lokacion, ka edhe hapësira tjera në afërsi të cilat mund t'i shfrytëzoj shkolla. Prona është e përshtatshme, sepse komuna nuk ka prona të tjera më të përshtatshme në atë pjesë. Meqë nuk ka diskutime të tjera, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për caktimin e Lokacionit për ndërtimin e shkollës së Re “ Ali Asllani në f. Doganaj, në Parcelën Kadastrale Nr. 00174-0, në sipërfaqe, 156m<sup>2</sup> në vendin e quajtur, “Fusha e Mulës- Katun” dhe në Parcelën Kadastrale Nr. 00175-0, në sipërfaqe 5584m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur “Fusha e Mulës – Ara të Shpija” ZK, Doganaj, pronë komunale, shfrytëzues, P.SH. Shtëpia e Shëndetit.**

**4.** Propozim Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të parcelave kadastrale Nr. 00229-2 dhe 00229-4, ZK Doganaj, në pronësi të Naser Guri;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kjo pikë është térheqë nga rendi i punës në mbledhjen e kaluar të Kuvendit të Komunës, pasi lënda nuk ka qenë e kompletuar. Vendimi për Hidrocentral në atë lokacion është marrë që 6 vite, ndërkaq ashtu qysh është dhënë leja nuk ka qenë në rregull marrja e veprës së ujit. Ndërkaq, tanë pala ka blerë pronë dhe do t'ia ndryshon

marrjen e veprës së ujit. Çdo devijim i projekteve të hidrocentraleve, tani e tutje duhet të sillen këtu në KK për miratim. Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin;

**z. Bekim Koxha,** Të Hidrocentralet, shihet qartë se po bëhet degradim i lumbit Lepenc, kështu duke u nisur nga kjo, kërkoj nga anëtarët e KK mos të votohet ky Propozim Vendim, sepse pasojat e ndërtimit të hidrocentraleve mund t'i shohim në të ardhmen.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Vendimi për ndërtimin e hidrocentralit në atë pjesë, është miratuar ka kohë, ndërkaq me këtë vendim i bëhet ndryshimi i marrjes së veprës së ujit. Për mua kjo është më e arsyeshme, ndërkaq, ndërtimi i hidrocentralit mbi lumen Lepenc në atë pjesë, është në përfundim e sipër.

**z. Bekim Koxha,** Në atë pjesë nuk duhet me u lejuar hiq dhënia e lejes ndërtimore për ndërtimin e hidrocentralit, sepse po degradohet lumi Lepenc, ashtu që uji po hynë në gypa dhe po mbesin pa ujitur tokat e bukës.

**z. Ukshin Qallaku - Drejtori i DUKMM,** Pala lejen ndërtimore për ndërtimin e hidrocentralit e ka, ndërkaq për këtë pronë, pala e ka bërë kërkësën më iu ndërruar destinimi, në mënyrë që me ia ndërruar kahen e marrjes së veprës së ujit hidrocentralit. Ndërrimi i kahes së marrjes së veprës së ujit, po na përgjigjet edhe neve, sepse lejen qysh e ka për marrjen e veprës së ujit, e degradon më tepër lumen Lepenc.

**z. Adnan Reka,** Degradimin e tokave bujqësore pa kriter e keni bërë sistem, ama me shkatërrimin e lumbit Lepenc që po ia bëni Komunës së Kaçanikut ju dhe legjislatura e kaluar me këta mini-hidrocentrale të mallkuar është e keqja më e madhe që ja keni bërë dhe po ja bëni këtij vendi, për çfarë unë mendoj se ju do të mbaheni përgjegjës ndër-breza.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Pala, lejen për ndërtimin e hidrocentralit, veprën e marrjes së ujit e ka në pellgun e lumbit Lepenc. Mirëpo, duke i pa reagimet e qytetarëve të komunës të asaj ane, ka blerë këtë pronë, me qëllim që t'ia ndërrroj kahen e veprës së marrjes se ujit. Tani e tutje, mua askush nuk mund të më bindë për çështjen e ndërtimit të hidrocentraleve, pasi ka edhe kërkesa të tjera.

**z. Adnan Reka,** Mirë kryesues që po reflekton tani, por çështja është, si keni pasur mundësi me marrë një vendim për ndërtimin e hidrocentralit në atë pjesë, pa bërë analiza në detaje, ndërkaq nuk e potenconi se jeni mashtruar më marrjen a atij vendimi.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Çështja është së deri të Ura në f. Doganaj, nuk kemi pasur mundësi të ndërpëmë ndërtimin e hidrocentralit, sepse është thënë se komuna do të merr 20% të energjisë elektrike nga lumenjtë. Për këtë çështje ka vendosur ministria (MMPH), ndërkaq pjesa nga f. Doganj-Kaçanik, duhet të mbrohet, sepse janë tokat bujqësore të cilat ujitën në atë pjesë. Nëse do të merrej vepra e ujit ashtu siç ka qenë më herët, atëherë fshati Doganaj do të ishte i rrezikuar.

**z. Shpend Krusha,** Më intereson të di, çka përfiton f. Doganaj, me këto devijime të marrjes së veprës së ujit të projektit të hidrocentralit.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Me këto ndryshime, është betonuar pellgu –vepra e marrjes së ujit, ndërkaq f. Doganaj nuk ka kurrfarë përfitimi. Tani më këto ndryshime, se paku mbrohet vepra e marrjes së ujit, sepse, nëse do të ishte vepra e marrjes së ujit qysh ka qenë më herët,

atëherë do të rrezikohej f. Doganaj. Punësimet janë 3 apo 4 veta, ndërkaq kryesorja është së mbrohet vepra e marrjes së ujit në lumin Lepenc.

**z. Besim Vishi,** Projekti i ndërtimit të Hidrocentralit, sa e di unë është në përfundim e sipër, ndërkaq, pasojat nuk janë të mëdha në pjesën ku është duke u vendosur tani vepra e marrjes së ujit. Aty përfitime kanë me pasur pronarët, ndërkaq rryma është e kapacitetit të ulët. Mirë që është kërkuar me u bërë ky ndryshim. Projektet tjera në të ardhshme duhet me i stopuar për ndërtimin e hidrocentraleve. Lidhur më këtë hidrocentral, Organizata “Gjethi” e ka publikuar Lejen e dhënë për ndërtimin e hidrocentralit në atë pjesë, ndërkaq ka reaguar për futjen në gypa të ujit të lumbit Lepenc i cili ujë shërben për ujitjen e tokave bujqësore në atë pjesë. Maksimumi edhe 2 vjet ka me u dhënë leje për hidrocentrale, sepse shteteve të BE sa e di unë, iu ka ndaluar kjo, për shkak të degradimit të pronave. Këtë po e themi në bazë një trajnimi të cilin e kam ndjekur. Më intereson të di, a janë të përcaktuara afatet kohore të marrjes së ujit, sepse, nëse i jepet leje për 365 ditë për shfrytëzimin e ujit nga hidrocentrali, kjo nuk është në rregull. Gjatë kohës së verës, uji i lumbit, duhet të jetë i lirë për ujitjen e tokave bujqësore, se paku 1/3 e ditëve të vitit.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Me Ligjin mbi Ujërat, i lejohen marrja e ujit për hidrocentrale për 2/3 e ditëve të vitit, ndërkaq 1/3 e kohës duhet të janë uji i lirë, mirëpo, kjo nuk ka ndodhur. Leja mjedisore, nuk mundet me iu dhënë palë, pa iu dhënë Pëlqimi nga komuniteti, sepse po degradohen pronat për gjatë ndërtimit të hidrocentraleve.

**z. Bekim Koxha,** Pse jemi atëherë në Kuvendin e Komunës, kur nuk mund të ndalim një të keqe të kësaj komune.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Çështjet të cilat janë në kompetencë të KK, ne mund t'i ndalim, ndërkaq për ato që nuk jemi kompetent, vendosë dikush tjetër. Në legjislaturën e kaluar janë marrë vendime për ndërtimin e hidrocentraleve, me çka kemi kujtuar se janë të mira. Tani e tutje, do të veprojmë në interes të qytetarëve tonë. Në legjislaturën e kaluar janë marrë disa vendime, duke menduar se janë të mira për të cilat na ka bindur edhe niveli qendror. Nëse ju mendoni së vepra e marrjes është me e mirë, atëherë duhet të jepni mendimin tuaj për më u bërë ky ndryshim.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi,** Është e vërtetë së më herët janë marrë disa vendime për ndërtimin e hidrocentraleve, ndërkaq koha e dëshmon se a janë të mira apo të këqija, për të cilat vendime na kanë bindur niveli qendror se janë në të mirë të komunës tonë dhe të qytetarëve të komunës tonë, për një zhvillim ekonomik, ndërkaq ne po i shohim tani këto vendime, por nuk jemi vetëm komuna jonë që kemi marrë vendime të tilla. Nëse ju mendoni se, vepra e marrjes se ujit e më hershme është më e mirë se kjo që është propozuar tani, jujeni i asaj ane dhe keni përgjegjësi morale ndaj komunitetit të asaj pjese, megjithëse edhe Kryesuesi i Kuvendit në mbledhjen e kaluar ka kërkuar informata shtesë lidhur me këtë propozim. Nëse mendoni së është më e mirë kjo vepër e marrjes së ujit, atëherë është mirë të kalon kjo çështje, nëse jo, atëherë mbetet vepra e marrjes së mëhershme si ka qenë më herët.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Vepra e marrjes së ujit, si e ka paraparë pala tani, e lehtëson lëvizjen e marrjes së ujit nga lumi Lepenc. Kjo lëvizje nuk e pengon, por e lehtëson marrjen e ujit të lumbit dhe vendoset mburojë për mbrojtjen e fshatit Doganaj. Ndërkaq, në anën profesionale, unë nuk jam inxhinier me i ditur këtë çështje, besoj se inxhinierët e kanë studiuar dhe vlerësuar këtë çështje, sepse paguhen me dhënë mendimin profesional, për me i ditur përparësitë apo dëmet që mund të ndodhin nga realizimi i projektit të hidrocentralit. Unë

nga këndi që e shoh këtë ndryshim, kujtoj së është me e mirë sesa vepra e marrjes së ujit si ishte më herët.

**z. Ekrem Raka,** Me vjen mirë që se paku në të ardhmen, do të ndalohet çështja e marrjes së vendimeve për ndërtim të hidrocentraleve. Unë nuk jam ekspert i kësaj fushe, kështu që nuk mund të vlerësoj se, a është më mirë apo me keq më e bërë ndryshimin e veprës së marrjes së ujit të hidrocentralit mbi lumin Lepenc në atë pjesë. Për këto arsyenë unë do të abstenoj kur të votohet kjo pikë.

**z. Besim Vishi,** Unë iu referova një trajnimit të ndjekur nga ana ime, në të cilin trajnim e kuptova së në të ardhmen nuk ka me pasur ndërtim të hidrocentraleve, sepse edhe shtetet e BE, nuk kanë me lejuar projekte të tilla.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, kështu këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë ishin 7 anëtarë, Abstenoj, Ekrem Raka. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

#### **VENDIM PARAPRAK**

**Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të pareelave kadastrale Nr. 00229-2 dhe 00229-4, ZK Doganaj, në pronësi të Naser Guri.**

**5.** Propozim Vendimi për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Kaçanikut.

**Kryesuesi i Kuvendit.** Sqaroj se nuk mund të procedojmë me emrat e propozuar, pasiqë i kemi dy Ankesa kundër listës së propozuar nga komisioni. Ankesat janë të kandidatëve: Bukurije Sopa dhe Shpresa Raka.

Pasi janë këto dy ankesa, ne jemi të obliguar me formuar një Komision për shqyrtimin e tyre. Atëherë kërkoj nga dy subjektet politike me të mëdh, PDK dhe LVV, të jalin nga një emër për anëtar të komisionit, ndërkaq anëtar i tretë do të jetë nga Ekzekutivi i Komunës. Nga PDK, Nexhat Loku e propozoj për anëtare të komisionit, znj. Lirije Shurdhani-Dema. Nga LVV, Ekrem Kyçyku e propozoj për anëtar të komisionit, z. Adnan Reka.

Propozimet që dolën për 2 anëtarët e komisionit nga Kuvendi i Komunës u shtruan në votim për aprovim dhe të njëjtë u aprovuan njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës, mori këtë:

#### **VENDIM**

**Për formimin e Komisionit të Ankesave për shqyrtimin e Ankesave për formimin e Komitetit Konsultativ të personave me aftësi të kufizuara, në përbërje, 3 anëtarë dhe atë:**

1. Lirije Shurdhani-Dema, anëtare, nga KK (PDK);
2. Adnan Reka, anëtar, nga KK (LVV);
3. Një anëtar nga Ekzekutivi i Komunës, i cili do të caktohet nga Kryetari i Komunës.

**Nga Ekzekutivi i Komunës, për anëtar të komisionit është caktuar, Mirlinda Dema.**

Kryesuesi i Komisionit zgjidhet nga anëtarëve të komisionit. Komisioni është vetëm për këtë Komitet Konsultativ, ndërkaq pasi të përfundoj punën e zgjedhjes së Komitetit Konsultativ, ky komision pushon së vepruari.

**6. Raporti i Punës i Komitetit për Komunitete, për vitin 2018:**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë Raport pune e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

**VENDIM**

**Për Aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2018.**

**8. Raporti i Punës së Komitetit për Shërbime Publike, për vitin 2018;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë Raport pune e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

**VENDIM**

**Për Aprovimin e Raportit të Punës së Komitetit për Shërbime Publike, për vitin 2018.**

Pas përfundimit të pikëve të rendit të punës, Kryesuesi i Kuvendit- Kemal Mërseli, e njoftoj KK për tri shkresa të arritura nga MAPL, lidhur me 3 vendime. E para është për 3.29 cent që është bërë gabim teknik, që u ndryshua dhe u plotësua vendimi i KK në këtë mbledhje-të bartja e mjeteve të paspenzuara të vitit 2018.

Për dy Vendimet tjera, Shkresat janë për ndarjen e Subvencioneve dhe transfereve, të cilat shkresa, pasi i kemi marrë nga qeveria, na kanë thënë se janë bërë disa gabime në to, kështu që të njëjta presim t 'na i sjellin më ndryshime në ndërkokë. Deri me tani nuk kemi ndonjë shkresë të korriguar nga Ministria e Financave e cila na konfirmohet përmes MAPL. Nëse dikush është i interesuar për shkresat e ministrisë për këto vendime, shkresat i kam unë, ndërkaq nuk e pashë të arsyeshme me ua shpërndarë.

**z. Ekrem Raka,** Kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit që për çdo shkresë që vjen nga MAPL lidhur më çështje të Kuvendit të Komunës, t 'na përcjellën edhe neve anëtarëve të KK.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu në ora: 12:26 Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj mbledhjen të përfunduar. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 26 anëtarë të KK, ndërkaq anëtarja, Vlora Dalloshi, ishte prezent vetëm në dy pikët e para, ndërsa për pikët tjera, kërkoj leje nga Kryesuesi i Kuvendit.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu  
*Malsiu*



**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 207);**

**në Mbledhja e III (Tretë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin  
2019, mbajtur me 29 Mars 2019.**

1. Kemal Mërseli....., \_\_\_\_\_,
2. Hamid Guri....., \_\_\_\_\_,
3. Ahmet Luma ....., \_\_\_\_\_,
4. Kadri Krivenjeva,....., \_\_\_\_\_,
5. Besim Vishi,....., \_\_\_\_\_,
6. Sali Malsiu....., \_\_\_\_\_,
7. Lirije Shurdhani....., \_\_\_\_\_,
8. Pranverë Loku- Zharku....., \_\_\_\_\_,
9. Lirije Luta....., \_\_\_\_\_,
10. Vlora Dalloshi....., \_\_\_\_\_,
11. Nexhat Loku ....., \_\_\_\_\_,
12. Shpend Krusha....., \_\_\_\_\_,
13. Adnan Reka....., \_\_\_\_\_,
14. Ekrem Kyçyku....., \_\_\_\_\_,
15. Fatijona Kyçyku....., \_\_\_\_\_,
16. Kaltrina Tafili ....., \_\_\_\_\_.
17. Selim Reka....., \_\_\_\_\_,
18. Besnik Salihu,....., \_\_\_\_\_,
19. Nazife Krasniqi....., \_\_\_\_\_,
20. Arlinda Rakoci-Raka....., \_\_\_\_\_,
21. Shemsedin Luzha....., \_\_\_\_\_,
22. Albana Troni....., \_\_\_\_\_,
23. Afërdita Shehi,....., \_\_\_\_\_,
24. Hajredin Luta....., \_\_\_\_\_,
25. Hafize Sallahi ....., \_\_\_\_\_,
26. Bekim Koxha....., \_\_\_\_\_,
27. Ekrem Raka,....., \_\_\_\_\_,



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**

**Komuna Kaçanik**  
**Opština Kaçanik**  
**Municipality Kaçanik**

<b>DATË/A:</b>	15.04.2019
<b>REFERENC-Ë:</b>	
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Delegatët e Kuvendit Komunal
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Fatmir Loku, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari <i>Fatmir L.</i>
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Përgjigjeje në pyetjen e deputetës znj. Afërdita Shehu - Horuni, lidhur me pyetjen për masat e ndërmarra për parandalimin e shkatërrimit të pyjeve në komunën e Kaçanikut

Përmes kësaj shkrese ju informojmë lidhur me aktivitetet e ndërmarra për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale. Sa i përket mbrojtjes së pyjeve për pjesën që ne jemi përgjegjës për mbrojtjen e pyjeve, ne si drejtori fillimisht kemi rritur numrin e punëtorëve ( 2 roje pylli) me kontratë në vepër për gjashtë muaj, me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbrojtjen e pyjeve, gjithashtu në bashkëpunim me policinë dhe rojet e pyllit kemi organizuar kontolle të përbashkëta në terren, si dhe inspektori i pylltarisë bënë kontrollimin në rrugë, kemi bërë konfiskime të masës drusore të cilat i kemi sjellë në autoparkun e shoqatës së Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës. Lidhur me masën drusore të konfiskuar kemi ngritur fletëparaqitje personave që janë hasur në brendi të pyllit, duke dëmtuar pyjet apo duke transportuar masë drusore.

Sa i përket pjesës së pyjeve në "Ahishtë" pjesë e Parkut Kombëtar Sharri ne edhe në njoftimet e mëhershme ju kemi informuar se përgjegjësia është e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në kuadër të së cilës funksionon Drejtoria e Parkut, me seli në Prizren.

Sa i përket pjesës së pyjeve në Parkun Kombëtar Sharri, ne në Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor vazhdimisht kemi përcjellë shkresa për ti informuar dhe ngritur shqetësimet tona, për gjendjen e krijuar në atë pjesë të pyjeve-pjesë e territorit të komunës sonë.



## Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergencave

Kaçanik, 26. 04. 2019

Për: Anëtarët e Kuvendit: z.Hajredin Luta,  
z.nj.Afërdita Horuni,  
z.Shpend Krusha,  
z.nj. Kaltrina Tafili,

### Lënda: PËRGJIGJE

Të nderuar,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruara para Kuvendit të Komunës, më datë 29. 03. 2019, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergencave.

#### **z.Hajredin Luta;**

Pyetja e dytë është për DSHPE; E di së është bërë një Marrëveshje për rehabilitimin e të gjitha rrugëve lokale që janë dëmtuar. Me intereson të di për trasenë e rrugës së f. Gajre, a është e mundur të bëhet kjo trase, kur ka me u rregulluar kjo, sa është gjerësia e rrugës dhe kush ka me realizuar atë projekt ?

➤ *Rruga Gajre- Ivaje, do të filloj së rehabilituari nga kompania Bektel Enka nga datë 27.04.2019. Me këtë rast edhe do të mbyllët përkohësisht kjo rrugë deri në finalizim të punimeve. Si pas dinamikës së paraparë kjo rrugë do të rehabilitohet deri me:*

*10 .05. 2019*

#### **z.nj.Afërdita Horuni;**

1. Pyetje e parë është për Drejtorin e Shërbimeve Publike; Kur do te merrni me riparimin e gropave ne qytet, pasi që dy aksidente ndodhen brenda një kohe të shkurtër: njëra ne bulevard dhe tjetra afër, Bubearit edhe pse kjo e fundit mund të thuash se nuk është kompetencë e komunës, mirëpo ju duhet të paraqitni ankesat në ministri apo ndoshta po pritni qe qytetarët t'i dërgojnë ankesat ?

➤ *Drejtoria e shërbimeve publike përmes kompanisë së kontraktuar për mirëmbajtjen e rrugëve lokale ka bërë sanimin dhe mbushjen e gropave me shtresë asfalti në hyrjen e qytetit, bulevardin e qytetit dhe në lokacionet e evidentuara nga drejtoria.*

**z. Shpend Krusha,** Kam një Kërkesë për DSHPE në emër të lagjes, Tifek, ashtu që rruga ku kyçesh në magjistrale, të pjesa e rrugës për Sllatinë, të vendoset një Pasqyrë, sikurse është vendosur në rrugën; Gajre- Ivajë, sepse ka probleme në atë pjesë.

- Drejtoria e Shërbimeve Publike çdo vit planifikon buxhet për sinjalizim horizontal dhe vertikal në rrugët lokale të komunës. Edhe këtë vit planifikojmë që të vendosim shenja të reja dhe riparimin e atyre të dëmtuara, ku me këtë rast do të planifikojmë edhe furnizim me pasqyre të tilla dhe vendosjen e tyre në kryqëzimet e rrugëve, ku mendohet që është e arsyeshme dhe obligative.

**znj. Kaltrina Tafili**, Kam një Ankesë nga qytetarët e Lagjes “Raif Krivenjeva” për çështjen e mungesës së ndriçimit publik në atë rrugë, sepse qytetarët e komunës në atë pjesë, janë të rezikuar në orët e natës, për shkak të mungesës së ndriçimit publik. Sa i përket ndriçimit publik, jo vetëm kjo rrugë, por edhe gjitha rrugët tjera të Kaçanikut, kanë nevojë për ndriçim publik.

- Gjatë këtij viti ekziston kodi buxhetor në kuadër të investimeve kapitale “Rregullim i ndriçimit publik” në vlerë 45,000.00€. Jemi në prepatitje të tenderdosjes për inicim të procedurave të prokurimit, ku me këtë rast planifikojmë edhe shtrirjen e rrjetit në lagjet urbane ku mungon rrjeti i ndriçimit publik.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!


Me respekt,



Ramadush Osmani  
Drejtor i DSHPE-së



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

## DREJTORIA E ARSIMIT DHE KULTURËS

**Përgjigje në pyetjen e z. Hajredin Luta:** Në shkollën fillore "Dituria" në f. Ivajë, nxënësit e klasës së dytë, ka një muaj ditë që janë pa arsimtar. Lidhur me këtë çështje është njoftuar edhe më herët drejtori i DAK. Pjetja është në emër të prindërve dhe të nxënësve; Përse nuk është bërë ende zëvendësimi i arsimtarit i cili ka punuar me klasën e dytë?

**Zëvendësim i arsimtarit nuk do të bëhet por deri në përfundim të vitit mësimor këta nxënës do të punojnë me klasë të kombinuar. Me kohë janë njoftuar edhe drejtori edhe prindët.**

**Përgjigje në pyetjen e znj. Arlinda Rakoci-Raka;** Kam një Kërkesë për Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës;

Duke parë shumë parregullsi në institucionin parashkollar QEAP "AGIMI", ju drejtohem që t'i ndërmerrni masat e nevojshme. Në këtë institucion, nëse një fëmijë ka ngecje në të folur, mos socializmi ose ndonjë nevojë tjetër të veçantë, aty diskriminohet, ndihet inferior dhe i pabarabartë me të tjerë. E nëse një ankesë e tille behet tek drejtoresha e këtij institucioni asnjëherë nuk gjen mbështetje dhe mirëkuptim, andaj ju drejtohem Juve si drejtor i arsimit. Edhe një gjë dua ta ceki, pasi kam qenë në këshillin drejtues të këtij institucioni kam dhënë dorëheqje pas incizimeve telefonike. Besoj së këto çështje do t'i merrni parasysh, sepse ka pasur edhe ankesa të tjera nga prindërit e fëmijëve të çerdhes.

**Sigurisht që ka probleme në QEAP "Agimi" si pasojë e disa faktorëve. Në rend të parë, mungesa e stafit profesional për punë me fëmijët me nevoja të veçanta sjellë probleme të natyrës çfarë ju theksoni. Shqetësimin e Juaj e të prindërve në përgjithësi e kemi marrë parasysh dhe kemi biseduar me stafin drejtues dhe puntorët e qerdhes dhe po tentojmë ta kryejmë detyrën sa më mirë të jetë e mundur.**

**Përgjigje në pyetjen e z. Ekrem Kyqyku:** A jeni në dijeni së në SHMP, "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka", një arsimtar i ofron cigare nxënësit të vet? A është marrë ndonjë veprim konkret nga organet përkatëse ndaj arsimtarit në fjalë?

**Jam në dijeni me veprimin e mësimdhënësit dhe për këtë janë marrë masa nga drejtori i shkollës në përputhje me ligjet në fuqi.**

**Përgjigje në pyetjen e z. Bekim Koxha,** Ku qëndron arsyaja që vetëm 8 nxënës të shkollës fillore në f. Koxhaj barten për në shkollë, ndërkaq nxënësit tjerë nuk bartën për në shkollë?

**Kur është ndërpore puna në shkollën e Koxhajve, në marrëveshje me prindërit kam garantuar që fëmijët që kanë qenë duke vazhduar mësimin në atë shkollë do të barten. Jam duke e përfillur këtë marrëveshje përndryshe distanca deri te shkolla amë nuk më obligon për me siguru bartjen.**

